



DREJTORIA E AKREDITIMIT E KOSOVËS
DIREKCIJA ZA AKREDITACIJU KOSOVA
KOSOVO ACCREDITATION DIRECTORATE



RAPORT VJETOR 2022



Përmbajtja

Historia e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës	4
Roli i Akreditimit	5
Fushat e aktivitetit të akreditimit nga DAK	6
Ecuria e punës së DAK-së gjatë vitit 2022	8
Skemat e raja të akreditimi	10
Sistemi i akreditimit	11
Bashkëpunimet ndërkombëtare	12
Realizimi i aktiviteteve të akreditimit sipas Planit të Punës	13
Laboratorët testues të akredituar sipas standardit SK ISO/IEC 17025:2017	14
Laboratorët mjekësor të akredituar sipas standardit SK EN ISO 15189:2020	14
Trupat inspektues të akredituar sipas standardit SK ISO/IEC 17020:2018	15

Lista e Shkurtesave

DAK - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës

TVK - Trupi për Vlerësim të Konformitetit

KA - Këshilli i Akreditimit

KP - Këshilli Profesional

EA - European Co-operation for Accreditation (Bashkëpunimi Evropian i Akreditimit)

ILAC - International Laboratory Accreditation Cooperation (Korporata Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve)

IAF - International Accreditation Forum (Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit)

MAC - Multilateral Agreement Council (Këshilli për Marrëveshje Multilaterale)

MLA - Multilateral Agreement (Marrëveshje Multilaterale)

FMG - Free Movements of Goods (Lëvizja e Lirë e Mallrave) dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar)

QI - Quality Infrastructure (Infrastruktura e Cilësisë)

LT - Laborator Testues

LK - Laborator Kalibrues

LM - Laborator Mjekësor

TI - Trup Inspektues

ISO - International Organization for Standardization (Organizata Ndërkombëtare për Standarde)

IEC - International Electrotechnical Commission (Komisioni Ndërkombëtar për Elektroteknik)

Historia e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës

- ❖ Shërbimi i akreditimit në Republikën e Kosovës filloi në vitin 2006. Së pari u krye nga Njësia për Akreditim e Agjencisë së Standardizimit (AKS) bazuar në Ligjin Nr. 02/L-043 për Akreditim dhe Urdhrin Administrativ 2006/15 për organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Akreditimit, datë 21.04.2006.
- ❖ Njësia e Akreditimit u nda nga Agjencia e Standardizimit dhe u bë një organ i pavarur kombëtar i akreditimit, i quajtur: Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK), në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Dhjetor 2008. Ajo u themelua me Ligjin Nr. 03/L-069 për Akreditim. Ligji Nr. 03/L-069 u ndryshua dhe plotësua më 28.06.2011 nga Ligji Nr. 04/L-007. Një ligj i ri për akreditim, Nr. 05/L-117, është publikuar më datë 12.01.2017 në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 765/2008.
- ❖ Misioni i DAK-së: ofrimi i shërbimeve të akreditimit në fushën e vlerësimit të konformitetit në nivel vendi, të rrisë ndërgjegjësimin për akreditim në shoqëri dhe të marrë një rol aktiv në përcaktimin e rregullave në infrastrukturën e cilësisë.
- ❖ Vizioni i DAK-së: shtimi i vlerës së produkteve dhe shërbimeve për një jetë më të sigurt për qytetareve tanë.

Roli i Akreditimit

- ❖ Akreditimi është një shërbim për komunitetin. Akreditimi siguron se trupat e akredituara që ofrojnë shërbime testimi, ekzaminimi, kalibrimi, certifikimi, inspektimi dhe verifikimi kanë kompetencën teknike dhe paanshmërinë për të kontrolluar konformitetin e produkteve dhe shërbimeve me standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.



ac | credit <latin>

të japësh besim, të besosh

Fushat e aktivitetit të akreditimit nga DAK

❖ Sipas nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-117, DAK ofron akreditim, duke zbatuar standardin kombëtar të Kosovës që miraton standardin përkatës evropian të harmonizuar dhe standardin ndërkombëtar, si dhe dokumentet e lëshuara nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit, të trupave të mëposhtëm të vlerësimit të konformitetit:

- ✓ laboratorët e testimit dhe kalibrimit;
- ✓ laboratorët mjekësorë;
- ✓ trupat inspektues;
- ✓ trupat për certifikimin e produkteve;
- ✓ trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit (cilësisë, ambientit etj.);
- ✓ trupat certifikues të personelit; dhe
- ✓ trupat tjerë për vlerësimin e konformitetit.



Si një palë e tretë e pavarur, DAK sigurohet që TVK-të e akredituara respektojnë standardet dhe deklaratat e tyre të konformitetit përbëjnë një garanci në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve.

Politika për kriteret dhe aktivitetet e akreditimit të DAK-së

- ❖ Kriteret dhe aktivitetet e akreditimit të DAK-së (përfshirë fushat teknike) përshkruhen në Politikë DAK-PO-03. Sipas kësaj politike, DAK aktualisht ofron akreditim të:
 - ✓ Laboratorëve të testimit sipas standardit ISO/IEC 17025;
 - ✓ Trupave inspektues sipas standardit ISO/IEC 17020;
 - ✓ Laboratorëve mjekësor sipas standardit ISO 15189.



*Foto1. Vlerësim i laboratorit testues sipas
standardit ISO/IEC 17025*

Ecuria e punues së DAK-së gjatë vitit 2022

- ❖ Edhe gjatë vitit 2022 DAK ka vazhduar të ofroj shërbime të akreditimit në mënyrë të paanshme, transparente dhe jo-diskriminuese.
- ❖ DAK vazhdon të jetë e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së vet në përputhje me Ligjin nr. 05/L-117 për akreditim, legjislacionin kombëtar në lidhje me akreditimin, ISO/IEC 17011:2017 dhe dokumentet e Bashkëpunimit Evropian për Akreditim (EA) dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Akreditimin e Laboratorëve (ILAC).



Objektivat e cilësisë së DAK-së:

- Rritja e kënaqësisë së autoriteteve dhe klientëve,
- Ulja e numrit të ankesave dhe apeleve,
- Ulja e nevojës për veprime korrigjuese,
- Përfshirja e suksesshme e kryevlerësuesve dhe vlerësuesve teknikë në proceset e akreditimit,
- Zhvillimi i skemave të reja të akreditimit,
- Trajnimi i stafit të brendshëm dhe të jashtëm të DAK-së të përfshirë në proceset e akreditimit,
- Vlerësimi i programeve të punës të realizuara dhe planeve financiare,
- Azhurnim i vazhdueshëm i sistemit të menaxhimit të DAK-së sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare, rregullave dhe dokumenteve të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit (EA dhe ILAC),
- Arritja e njohjes evropiane dhe ndërkombëtare (EA BLA, ILAC MRA).



Skemat e raja të akreditimi

DAK mund të zhvillojë aktivitetet e saj për akreditimin e skemave të reja të akreditimit (p.sh., trupat për certifikimin e produkteve, trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit, trupat certifikues të personave ose trupat e tjerë për vlerësimin e konformitetit) në rast se ekziston një nevojë e shprehur nga tregu, një kërkesë e autoriteteve kompetente ose nëse legjislacioni i brendshëm imponon akreditim. DAK i zgjeron aktivitetet e saj vetëm në rast se një standard i akreditimit është në fuqi në nivel evropian ose ndërkombëtar.



Foto2. Vlerësim i laboratorit mjekësor sipas standardit ISO 15189



*Foto 3
Vlerësim i laboratorit testues sipas*

Sistemi i akreditimit

Rregullorja (EC) Nr. 765/2008 përcakton kuadrin ligjor për akreditimin në Evropë, duke përcaktuar kërkesat për akreditimin në lidhje me marketingun e produkteve.

Ajo jep një qasje të harmonizuar dhe rigoroze për akreditimin në të gjithë shtetet anëtare të BE-së – kështu që në fund një certifikatë ose raport akreditimi do të mjaftojë për të demonstruar kapacitetin teknik të një trupi të akredituar.

Parimet kryesore të akreditimit në Rregullore- që plotëson kërkesat e standardit ISO/IEC 17011 dhe standardet e tjera ndërkombëtare për trupat e vlerësimit të konformitetit – janë:

- ☐ një trup akreditimi për çdo shtet anëtar;
 - ☐ akreditimi operohet si aktivitet i autoritetit publik;
 - ☐ nuk ka konkurrencë në mes trupave kombëtare të akreditimit dhe në mes tyre dhe trupave të vlerësimit konformitetit;
 - ☐ veprimtari jofitimprurëse; ☐ përfaqësimi i palëve të interesit.
-
- ☐ Azhurnim i vazhdueshëm i sistemit të menaxhimit të DAK-së sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare, rregullave dhe dokumenteve të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit (EA dhe ILAC),
 - ☐ Arritja e njohjes evropiane dhe ndërkombëtare (EA BLA, ILAC MRA).

Buxheti i vitit 2022

Buxheti i aprovuar i DAK-së për vitin 2022 ishte 93,281.00 €, nga të cilat Paga dhe shtesa kanë qenë 66,168.00€ ndërsa Mallra dhe Shërbime kanë qenë 27,113.00 €. Realizim i buxhetit për Paga dhe mëditje ka qenë 80.87%, ndërkaq për Mallra dhe Shërbime ka qenë 89.60%. Në total realizimi i buxhetit ka qenë 85,59%.

Bashkëpunimet ndërkombëtare

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës, edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar të ketë marrëdhënie të mira bashkëpunimi me të gjitha Trupat Akreditues të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

Shkëmbimi i përvojave dhe njohurive, si dhe shfrytëzimi i ndërsjellët i eksperteve teknik në procese të vlerësimit për akreditim, kanë qenë aktivitete të realizuar si rezultat i këtyre bashkëpunimeve.

DAK vazhdon të jetë anëtare me të drejta jo të plota në:

- ☐ EA – European co-operation for Accreditation
- ☐ ILAC – International Laboratory Accreditation Co-operation, dhe
- ☐ IAF – International Accreditation Forum.

Ndërkaq marrëveshjet e bashkëpunimit (MoU) vazhdon të ketë me Trupat Akredituese Rajonale:

- ☐ MoU me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit-Shqipëri (DPA)
- ☐ MoU me Institutin e Akreditimit të Maqedonisë (IARM)
- ☐ MoU me Agjencinë Turke të Akreditimit (TURKAK)
- ☐ MoU me Agjencinë Kroate të Akreditimit (HAA)
- ☐ MoU me Trupin Akreditues të Rumanisë (RENAR).



Foto 4. Pjesëmarrje në Komitetin Teknik për Komunikim dhe Publikim

Realizimi i aktiviteteve të akreditimit sipas Planit të Punës

- ❖ Bazuar në Planin e Punës, DAK gjatë vitit 2022 ka realizuar aktivitete të ndryshme të akreditimit, siç janë: vlerësim për akreditim fillestar, mbikëqyrje, zgjerim të fushës së akreditimit si dhe vlerësim të jashtëzakonshëm, të cilat aktivitet janë realizuar në hapësirat e trupave të Vlerësimit të Konformitetit (TVK). Gjithashtu DAK ka realizua edhe aktivitetet në zyre të DAK-së siç janë: shqyrtim i dokumenteve të Sistemit të Menaxhimit të TVK-ve për akreditim të tyre si, shqyrtim të dokumenteve të Sistemit të Menaxhimit të TVK-ve për ri-akreditim ose zgjerim të fushës si dhe takime të Këshillit të Akreditimit

Aktiviteti në terren	Laboratorë Testues	Trupa Inspektues	Gjithsej
Mbikëqyrje	12	3	15
Mbikëqyrje dhe zgjerim	2	2	4
Ri-akreditim	5	5	10
Pjesëmarrje vëzhguese në procesin e akreditimit të TVK-së nga një Trupit Akreditues i huaj	1		1
Vlerësim i jashtëzakonshëm		1	1
Vlerësim fillestar	7	4	11
Zgjerim i fushës së akreditimit	2		2
Gjithsej sipas kategorisë	29	15	44

Aktivitetet në zyre	Laboratorë Testues	Trupa Inspektues	Gjithsej
Shqyrtim i dokumenteve të Sistemit të Menaxhimit të TVK-ve	8	10	18
Shqyrtim i dokumenteve të Sistemit të Menaxhimit të TVK-ve për Ri-akreditim	6	2	8
Takime të Këshillit të Akreditimit			22

TVK te akredituara (31.12.2022)	Laboratorë Testues	Trupa Inspektues	Gjithsej
Akreditim aktiv	34	19	53
të pezulluara	0	1	1
Gjithsej	34	20	54

Laboratorët testues të akredituar sipas standardit SK ISO/IEC 17025:2017

Emri i Laboratorit Testues	Fusha e Akreditimit
„IPE CONTROLS-ING“ SH.P.K	Laborator për analiza fiziko-mekanike të materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit
"IMK Ballkan Projekt" Sh.P.K	Laborator për shqyrtimin e materialeve ndërtimor, hulumtimeve gjeologjike dhe gjeomekanike, matjet elektrike, seizmike, ambienti dhe uji
"M&Silloi"	Laborator testimit të miellit dhe grurit
IMN "Test-Beton" SH.P.K	Laborator për ekzaminimin e materialeve ndërtimore beton, asfalt dhe agregate
Agjencia e Kosovës për Forenzikë - AKF	Laborator i ADN/Serologji; Laboratori për analiza kimike të narkotikëve; Laborator i balistikës; Laboratori i dokumenteve dhe dorëshkrimeve; Laborator i daktioskopisë dhe traseologjisë; Laborator për analize të eksploziveve dhe zjarrëvënjeve
"EUROPE SYSTEMS"	Laborator i matjeve elektrike
Qendra e Laboratorëve Testues - UBT	Laboratori i materialeve ndërtimore
TREPARM SH.P.K	Laborator farmaceutik dhe laborator i ushqimor
Korporata "Sara&Meti" Sh.p.k	Laborator analitik, bujqësor dhe i ushqimit
"FERTEST"sh.p.k	Laborator për materiale ndërtimore
Geokos A & A O.P	Laborator testues i gjeomekanikës
NSH "IBMS"	Laborator i materialeve të ndërtimit
STUDIO CENA SH.P.K	Laborator për testim të materialeve ndërtimore
Byro projektuese STRUKTURA	Laborator i materialeve ndërtimore
K.R.U HIDROREGJIONI JUGOR SH.A	Laborator i ujit
Dogana e Kosovës	Laborator Doganorë i naftës
Kosova-Lab	Laborator për cilësinë e derivateve të lëngëta të naftës
KRU "Gjakova" SHA	Laborator fiziko-kimik dhe bakteriologjik i ujit
Silca Group SH.A.	Laborator i ujit "MIROS"
IPE PROING SH.P.K	laborator i materialeve ndërtimore
SharrCem SH.P.K	Laborator për testime kimike dhe fiziko mekanike të çimentos
N.Sh. "TEST&ING"	Laborator i përzjerjeve bituminoze dhe hulumtimeve gjeomekanike
"ACT-ing" SH.P.K	Laborator i materialeve ndërtimore
N.SH"ETL-KOSOVA"	Laborator për ekzaminimin e materialeve ndërtimore dhe shqyrtimin e konstruksioneve
AUV	Laborator i Ushqimit dhe Veterinarisë
Sh.A."Birra Peja"	Laborator Qendror i analizave kimike dhe mikrobiologjike të birrës, ujit dhe lëngjeve
INKOS	Laborator Testues i: Gjeomekanikës/ Lëndëve Djegëse /Matjeve elektrike/ Mjedisit/ Kontrollit pa shkatërrim / Defektoskopisë
Ex Fis LABS SH.P.K	Laborator për analiza të derivateve të lëngëta të Naftës
"ADEA GROUP" Sh.p.k	Laborator testues i Ujit
Stone Castle Vineyards L.L.C	Laborator për testimin e parametrave fiziko-kimike të verërave dhe pijeve të forta alkoolike
N.P.N "AK-COMPANY" Sh.p.k	Laborator i testimit të betonit produkteve të tij dhe përzjerjes bituminoze
EUROLAB SH.P.K	Kontrollimi teknik i automjeteve
Ballkan Petrol SH.P.K	Laborator për testimet fiziko-kimike të vajrave
RICENS SH.P.K	Laborator i materialeve dhe strukturave ndërtimore

Laboratorët mjekësor të akredituar sipas standardit SK EN ISO 15189:2020

Emri i Laboratorit Mjekësor	Fusha e Akreditimit
"OLIVE MEDICAL & GROUP" SH.P.K, Olive Medical & Laboratory	Biokimi, Hematologji

Trupat inspektues të akredituar sipas standardit SK ISO/IEC 17020:2018

Emri i Trupit Inspektues	Fusha e akreditimit
Euro-Inspekt N.SH.	Inspektimi i cilësisë së produkteve të naftës dhe verifikimi i rrjedhjes së produkteve të naftës
GMC Kosova SH.P.K	Inspektimi i ashensorëve, vinçave dhe eskalatorëve
Ealga SH.P.K	Inspektimi i ashensorëve, vinçave dhe eskalatorëve
SIERRA-LAB SH.P.K	Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës si verifikimi i mjeteve matëse të rrjedhjes së naftës
Olti SH.P.K.	Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës
EUROLAB SH.P.K	Inspektimi/ homologim i automjeteve
Fakulteti i Inxhinierise Mekanike UP Hasan Prishtina	Inspektimi/homologim i automjeteve
N.SH. SNAP-ON KOSOVA	Inspektimi/verifikim i mjeteve matëse në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve
N.T.P. Eramed	Inspektimi periodik dhe i jashtëzakonshëm i peshoreve jo-automatike
TAHOGRAPH SH.P.K	Inspektimi/verifikimi i tahografëve dhe taksimetrave
G.T.T. Service N.T.P	Inspektim/verifikimin e tahografëve dhe taksimetrave
EJUP RAMADANI B.I. D.P.Z. KIENZLE	Inspektim/verifikimi i tahografëve
Arben Xhigoli B.I. N.P. TAHO-TRIO	Inspektim/verifikimi e tahografëve
D.P.Z. Autoelektricit-Tahografist Bosch	Inspektim /verifikimin e tahografëve
PESHOJA NEW SH.P.K	Verifikimin e peshoreve jo-automatike të klasit II, III, IV
Kontroll Test SH.P.K	Inspektimi i pajisjeve nën presion
Arben Lushta B.I. D.P.T. Monark Auto Tacho	Inspektim /verifikim i tahografëve
Tacho ZMB SH.P.K	Inspektim /verifikimin i tahografëve
Arbenita Duraku B.I. TACHO TECH	Inspektim /verifikimin i tahografëve
NDT Kontrolli Sh.P.K	Inspektimi i pajisjeve nën presion
Green Tech Industry L.L.C	inspektim /verifikim i tahografëve